



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FIER  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË PRONAVE

Nr. 10635 Prot.

Fier, më 19.09.2025

Projekt - Vendim

Nr. 88 datë 19.09.2025

**“Për miratimin e kërkesës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të pasurisë nr. 86/18 zk. 3031 e llojit “ullishte” me sipërfaqje 187 800 m<sup>2</sup>, e ndodhur në territorin e Njesisë Administrative Portëz Bashkia Fier, tokë shtetërore me origjinë nga ish – NB Frutore”, pasuri në përdorim të Bashkisë Fier”**

Në bazë të nenit 8, pika 2, nenit 54, shkronja “e/1”, nenit 55, pikat 4 dhe 6 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 510 datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të pa trupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore të prekura nga riorganizimi administrativo - territorial”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 901 dt. 21.12.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Njesisë Administrative Portëz Bashkia Fier Qarku Fier”, kërkesën Nr.1796/2 prot, datë 11.07.2025 të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural , **Kryetari i Bashkisë;**

**PROPOZON**

1. Miratimin e kërkesës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për kalimin në administrim të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të pasurisë nr. 86/18 zk. 3031 me sipërfaqje totale nr. 187 800 m<sup>2</sup> ndodhur në fshatin Portëz Njësia Administrative Portëz Bashkia Fier, sipas Çertifikatës së Rregjistrimit të Pronës (në përdorim të Komunës Portëz, bazuar në VKM nr. 901 dt. 21.11.2011), tokë shtetërore me origjinë nga ish – NB Frutore”, pronë në përdorim të Bashkisë Fier.
2. Autorizohet ekzekutivi i Bashkisë Fier për vijimin e procedurave të mëtejshme administrativo – ligjore me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural .

Drejtoria e Menaxhimit të Pronave

Drejtori: A. Behari

Drejtorja Juridike

Drejtoresha: E. Kapllanaj

**KRYETARI**

**Armando SUBASHI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**

**NËNKRYETARE**

**Suela PRIFTI**

